



|  |            |
|--|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO                        |            |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY |            |
| Dep. / Dep. / Dep.   | 2-D        |
| Nr. Prot. / B. Prot. / Prot. No.   | 01-331/16  |
| Data / Datum / Dat.  | 28.01.2016 |
| Nr. Esh. / No. Esh. / No.  | 02         |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.01.2016, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4270/15, për znj. Drita Grazhda, ish Kryesuese e Bordit në Ndërmarrjen Publike KRU Hidroregjioni Jugor Sh.A - Prizren, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtimin e Funkcionit Publik për zyrtaren e lartë, znj. Drita Grazhda, ish Kryesuese e Bordit në Ndërmarrjen Publike KRU Hidroregjioni Jugor Sh.A - Prizren, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funkcionit Publik.

Zyrtarja e lartë, znj. Grazhda është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Zyrtarja e lartë është kontaktuar nga zyrtari i Agjencisë për të njoftuar lidhur me rastin. Mirëpo znj. Grazhda ka deklaruar se nuk është duke ushtruar funksionin e Kryesueses së Bordit në Ndërmarrjen Publike KRU Hidroregjioni Jugor Sh.A – Prizren.

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar një shkresë zyrtare nga pika kontaktuese me AKK - në e Ndërmarrjes Publike KRU Hidroregjioni Jugor Sh.A – Prizren, në të cilën vërtetohet se zyrtarja e lartë nuk është duke ushtruar funksionin e lartëpërmendur që nga data 31.10.2015.

Duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit konsiderojmë se nuk kemi situatë të shkeljes së dispozitave të këtij Ligji, prandaj pushojnë hetimet për Konflikt Interesi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni  
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

